



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

**VENDIM**

**Nr 159 datë 23.10.2015**

**Për marrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor**

Në zbatim të ligjit nr 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 10, pika 3, nën pika I, gërma g, i ndryshuar, ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 12, neni, 13, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" neni 58, Kryetari i Bashkisë

**VENDOSI:**

1. Ngarkimin e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec, për Përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, sipas ligjit, për marrjen e nismës së hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Planifikimit të Territorit për të gjithë territorin administrativ që mbulon Bashkia Pogradec. Mbështetur në ligjin, nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 12, neni, 13, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" neni 58, dokumentacioni duhet të përmbajë:

1. Analizën e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartimin dhe rishqyrtimin të dokumentit të planifikimit.
2. Dokumentat që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas ligjit
3. Kufijtë e territorit të Bashkisë
4. Planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor
5. Strategjinë e miratimit të tij: në një apo dy ndalesa;
6. Listën e dokumentave përbërëse të PPV-së
7. Ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PPV.
8. Forumi Këshillimor i Planit
9. Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike me afatet përkatëse.
10. Buxheti për hartimin e PPV-së.
11. Vendimi për pezullimin e zhvillimit për të gjithë ose një pjesë të territorit shoqëruar me hartën përkatëse

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Eduart KAPRI**



Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku" Lagja: Nr.2  
Tel: +355 (83) 22222, +355 (83) 22465 Fax: +355 (83) 22441, +355 (83) 22424  
E-mail: [zyrainfo@gmail.com](mailto:zyrainfo@gmail.com), [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)